



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0884

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Kimete Gashi Brajshori duke vendosur sipas ankesës së (OE) “BAZALTI-S” SH.P.K., kundër vendimit për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të “KUVENDI KOMUNAL – RAHOVECË” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “NDËRTIMI I URAVE NË KOMUNËN E RAHOVECIT” me numër të prokurimit 623-24-5118-5-2-1, me 19/11/2024, mori:

Vendim

- 1. Aprovohet**, si e bazuar ankesa e OE “BAZALTI-S” SH.P.K. me nr. 2024/0884, e datës 20/09/2024, kurse vendimi i AK “KUVENDI KOMUNAL – RAHOVECË” lidhur me aktivitetin e prokurimit “NDËRTIMI I URAVE NË KOMUNËN E RAHOVECIT” me numër të prokurimit 623-24-5118-5-2-1 anulohet, ndërkaq aktiviteti i prokurimit kthehet në **Rivlerësim**.
2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
3. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik "BAZALTI-S" SH.P.K.
4. Meqenëse ankesa e OE ankues aprovohet si e bazuar, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me datën 24.05.2024 “KUVENDI KOMUNAL – RAHOVECË” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar B05 Njoftimin për Kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me “NDËRTIMI I URAVE NË KOMUNËN E RAHOVECIT” me nr. te prokurimit 623-24-5118-5-2-1. Ndërsa me datën 05.09.2024 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues për dhënie të kontratës.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të **hapur**, lloji i kontratës: - **punë**, vlera e parashikuar e kontratës: 188,349.79 euro.

Me 10.09.2024, OE “BAZALTI-S” SH.P.K. ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Më 11.09.2024, Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar si te pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 20.09.2024, OSHP ka pranuar ankesën nga OE “BAZALTI-S” SH.P.K. me nr. 2024/0884 për lidhur me aktivitetin “NDËRTIMI I URAVE NË KOMUNËN E RAHOVECIT” me nr. të prokurimit: "623-24-5118-5-2-1".

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “BAZALTI-S” SH.P.K janë parashtruar si në vijim: Njoftimi për Kontratë është bërë me dt. 24.05.2024, kurse hapja e ofertave është bërë me dt. 25.06.2024, ku kanë marrë pjesë 4 ofertues. Njoftimi mbi vendimin e parë të AK-së është publikuar me dt. 27.06.2024 ku është rekomanduar për kontratë grupi i OE “GZIMI-GARTEN-UND LANDSCHATSB AU SH.P.K & AGE Group SH.P.K. ”, kurse neve na është dërguar letra standarde përtenderues të pasuksesshëm. Kundër njoftimit mbi vendimin e lartcekur, ne kishim parashtruar kërkesë për rishqyrtim, e më pastaj edhe ankesë në OSHP. Në lidhje me ankesën tonë është nxjerr ekspertiza nga ekspertja shqyrtuese dhe vendimi i panelit shqyrtues të OSHP-së me nr.2024/0618, ku është aprovuar ankesa jonë si e bazuar dhe është detyruar autoriteti kontraktues që lëndën ta kthej në rivlerësim. Pasi që lënda është kthyer në rivlerësim, autoriteti kontraktues me dt.05.09.2024 ka publikuar njoftimin mbi vendimin e AK-së ku është rekomanduar për kontratë përsëri grupi i OE “GZIMI-GARTEN-UND LANDSCHATSB AU SH.P.K & AGE Group SH.P.K. ”, kurse neve na është dërguar përsëri letra standarde për tenderues të pasuksesshëm. Ne përsëri ke përsëri kemi ardh në përfundim që i OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm për faktet si në vijim: OE i rekomanduar për kontratë, është i papërgjegjshëm për faktin se nuk e ka plotësuar kërkesën e dosjes së tenderit ku është kërkuar “2.1. Menaxheri i Projektit – Inxhinier i Diplomuar Ndërtimtarisë ose master – Drejtimi Konstruktiv, me përvojë pune min. 6 vite pas diplomimit”, ndërsa dëshmia dokumentare është kërkuar “Dëshmia 2 Diplomati përkatëse – Kopje të noterizuar, (noterizimi të prezantohet nga

vetë inxhinieri te noteri), Nëse shkollimi është kryer jashtë Kosovës diploma e fakultetit duhet të jetë e nostrifikuar konform ligjeve në fuqi të Republikës së Kosovës; •Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhim për këtë projekt, (Nëse prezantoni kontrata te rregullt te dëshmohet me liste te ATK ne tre (3) muajt e fundit, nëse prezantoni marrëveshje për këtë projekt duhet te jete e noterizuar ne prani te palëve); CV-në (të nënshkruar nga vetë pala);Letër referencë për punët e mëparshme në lëmin e kërkuar e lëshuar nga punëdhënësit”.OE i rekomanduar për kontratë në ofertë si menaxher të projektit ka prezantuar z. Bushra Hasani, mirëpo i njëjti nuk e plotëson kërkesën e dosjes së tenderit për faktin se në dokumentet që ne kemi pasur qasje e kemi vërejtur vetëm një referencë, të lëshuar nga anëtari i grupit të OE AGE Group SHPK i cili nuk e dëshmon përvojën prej 6 viteve të kërkuara pas diplomimit. Gjithashtu në CV e inxhinierit të lartcekur nuk figuron projekti për të cilën është e lëshuar referenca, andaj në këtë rast ka mospërputhje mes CV-së dhe referencës. Nga dëshmitë e prezantuara për inxhinierin e lartcekur në asnjë mënyrë nuk dëshmohet përvoja prej 6 viteve pas diplomimit për menaxherin e projektit.

Gjithashtu për të njëjtin, grupi i OE të rekomanduar për kontratë ka prezantuar në ofertë një kontratë pune për kohë të pacaktuar, mirëpo për të njëjtin nuk është prezantuar dëshmia nga ATK, pasi që kërkesë e dosjes së tenderit ka qenë që *“Nëse prezantoni kontrata te rregullt te dëshmohet me liste te ATK ne tre (3) muajt e fundit”*. Andaj duke u bazuar në këtë fakt kuptohet qartë se OE i rekomanduar për kontratë nuk e plotëson kërkesën e dosjes së tenderit dhe si i tillë nuk mund dhe nuk është dashur të rekomandohet për kontratë. Në lidhje me pretendimin e lartcekur paneli shqyrtues në vendimin e tij, i ka falur besimin konstatimeve të ekspertës shqyrtuese, mirëpo ne ju sqarojmë se në këtë rast nuk janë analizuar në tërësi të gjitha faktet dhe argumentet tona. Ekspertja shqyrtuese në lidhje me përvojën e menaxherit të projektit e ka cekur se Nuk ka qenë kërkesë e Autoriteti Kontraktues që CV dhe referenca te jene identike andaj ekspertja sqaron se dokumente e dorëzuar janë komfor kërkesave te Autoriteti Kontraktues (bashkangjitur do gjeni dëshminë ne fund te Raportit).

Ky konstatim është jo profesional, sepse pretendimi ynë ka qenë që ka mospërputhje të dëshmive në lidhje me përvojën e punës, prandaj ky fakt është dashur të vërtetohet nga ekspertja shqyrtuese sepse sipas referencës së lëshuar nga AGE Group nuk e dëshmon përvojën prej 6 viteve të kërkuara pas diplomimit. Ekspertja ka konstatuar se përvoja llogaritet nga koha e diplomimit, mirëpo ne sqarojmë se përvoja duhet të llogaritet nga momenti që ka filluar të punojë personi e jo nga diplomimi. Po ashtu kontrata nuk ka qenë e prezantuar vetëm për këtë projekt, por ka qenë pa afat e që konsiderohet kontratë e rregullt, prandaj është dashur të ofrohen dëshmitë ga ATK-ja e që realisht nuk janë prezantuar, prandaj konstatimet e ekspertës shqyrtuese nuk kanë qenë të drejta dhe të sakta, andaj edhe paneli shqyrtues është dashur të mos i merr parasysh këto konstatime. Kërkesa e dosjes së tenderit ka qenë shumë e qartë: (Nëse prezantoni kontrata te rregullt te dëshmohet me liste te ATK ne tre (3) muajt e fundit, nëse prezantoni marrëveshje për këtë projekt duhet te jete e noterizuar ne prani te palëve). Përderisa nuk janë prezantuar dëshmitë nga ATK për inxhinierin sipas kërkesës së lartcekur, atëherë është i qartë fakti se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm.

OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm edhe për faktin se nuk e ka plotësuar edhe kërkesën tjetër të dosjes së tenderit, ku kërkesë ka qenë *“2.2. Udhëheqësi i Punishtes – Inxhinier i Diplomuar i Arkitekturës ose master, me përvojë pune min. 5 vite pas diplomimit”, ndërsa dëshmia dokumentare është kërkuar “Dëshmia 2Diplomat përkatëse – Kopje të noterizuar, (noterizimi të prezantohet nga vetë inxhinieri te noteri), Nëse shkollimi është kryer jashtë Kosovës diploma e fakultetit duhet të jetë e nostrifikuar konform ligjeve në fuqi të Republikës së*

Kosovës; •Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhim për këtë projekt, (Nëse prezantoni kontrata te rregullt te dëshmohet me liste te ATK ne tre (3) muajt e fundit, nëse prezantoni marrëveshje për këtë projekt duhet te jete e noterizuar ne prani te palëve); •CV-në (të nënshkruar nga vetë pala); •Letër referencë për punët e mëparshme në lëmin e kërkuar e lëshuar nga punëdhënësit”.

OE i rekomanduar për kontratë në ofertë si udhëheqës të punishtes ka prezantuar z. Sami Hoxha, mirëpo i njëjti nuk e plotëson kërkesën e dosjes së tenderit për faktin se në dokumentet që ne kemi pasur qasje e kemi vërejtur vetëm një reference, te lëshuar nga anëtari i grupit të OE AGE Group SHPK e cila nuk e dëshmon përvojën prej 5 viteve të kërkuara pas diplomimit. Gjithashtu në CV e inxhinierit të lartcekur nuk figuron projekti për të cilën është e lëshuar referenca, andaj në këtë rast ka përrputhje mes CV-së dhe referencës. Nga dëshmitë e prezantuara për inxhinierin e lartcekur në asnjë mënyrë nuk dëshmohet përvoja prej 5 viteve pas diplomimit për menaxherin e projektit. Gjithashtu për të njëjtin, grupi i OE të rekomanduar për kontratë ka prezantuar në ofertë një kontratë pune për kohë të caktuar, mirëpo për të njëjtin nuk është prezantuar dëshmia nga ATK, pasi që kërkesë e dosjes së tenderit ka qenë që “Nëse prezantoni kontrata terregullt te dëshmohet me liste te ATK ne tre (3) muajt e fundit”. Po ashtu Afati i kontratës se punës të prezantuar për të njëjtin 22.02.2024-22.02.2026, nuk e mbulon afatin kohor te implementimit te projektit sepse periudha e caktuar nga AK është 24 muaj. Andaj duke u bazuar në këtë fakt kuptohet qartë se OE i rekomanduar për kontratë nuk e plotëson kërkesën e dosjes së tenderit dhe si i tillë nuk mund dhe nuk është dashur të rekomandohet për kontratë.

OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm edhe për faktin që nuk e plotëson edhe kërkesën tjetër të dosjes së tenderit ku është specifikuar “2.3. Inxhinier i Diplomuar ne Inxhinieri Elektroteknike ose master - me përvojë pune min. 5 vite pas diplomimit”, ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar “Dëshmia 2 •Diplomat përkatëse – Kopje të noterizuar, (noterizimi të prezantohet nga vetë inxhinieri te noteri), Nëse shkollimi është kryer jashtë Kosovës diploma e fakultetit duhet të jetë e nostrifikuar konform ligjeve në fuqi të Republikës së Kosovës; •Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhim për këtë projekt, (Nëse prezantoni kontrata te rregullt te dëshmohet me liste te ATK ne tre (3) muajt e fundit, nëse prezantoni marrëveshje për këtë projekt duhet te jete e noterizuar ne prani te palëve); •CV-në (të nënshkruar nga vetë pala); •Letër referencë për punët e mëparshme në lëmin e kërkuar e lëshuar nga punëdhënësit”.

OE i rekomanduar për kontratë për kërkesën e lartcekur ka prezantuar inxhinierin z. Valon Jahaj, të cilit afati i kontratës së punës i figuron nga data 28.02.2024 deri më 28.02.2026. I njëjti inxhinier nuk e plotëson kërkesën e lartcekur për faktin se për të njëjtin nuk është prezantuar dëshmia nga ATK, pasi që kërkesë e dosjes së tenderit ka qenë që “Nëse prezantoni kontrata te rregullt te dëshmohet me liste te ATK ne tre (3) muajt e fundit”. Po ashtu Afati i kontratës se punës të prezantuar për të njëjtin 28.02.2024 deri më 28.02.2026, nuk e mbulon afatin kohor te implementimit te projektit sepse periudha e caktuar nga AK është 24 muaj.

OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm edhe për faktin që nuk e plotëson edhe kërkesën tjetër të dosjes së tenderit ku është specifikuar “Master ose Bachelor i diplomuar në Menaxhimin e Emergjencave, Master me Tre (3) vite përvojë pune pas diplomimit ose Bachelor i diplomuar me Pesë (5) vite përvojë pune pas diplomimit”, ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar “Dëshmia 2•Diplomat përkatëse – Kopje të noterizuar, (noterizimi të prezantohet nga vetë inxhinieri te noteri), Nëse shkollimi është kryer jashtë Kosovës diploma e fakultetit duhet të jetë e nostrifikuar konform ligjeve në fuqi të Republikës së Kosovës; •Kontrata e punës me

punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhim për këtë projekt, (Nëse prezantoni kontrata të rregullt të dëshmohet me liste të ATK në tre (3) muajt e fundit, nëse prezantoni marrëveshje për këtë projekt duhet të jete e noterizuar në prani të palëve); •CV-në (të nënshkruar nga vetë pala); •Letër referencë për punët e mëparshme në lëmin e kërkuar e lëshuar nga punëdhënësit". OE i rekomanduar për kontratë për kërkesën e lartcekur ka prezantuar inxhinierin z. Gazmend Begaj, të cilit afati i kontratës së punës i figuron nga data 26.02.2024 deri më 26.02.2026. I njëjti inxhinier nuk e plotëson kërkesën e lartcekur për faktin se për të njëjtin nuk është prezantuar dëshmia nga ATK, pasi që kërkesë e dosjes së tenderit ka qenë që "Nëse prezantoni kontrata të rregullt të dëshmohet me liste të ATK në tre (3) muajt e fundit". Po ashtu Afati i kontratës së punës të prezantuar për të njëjtin 26.02.2024 deri më 26.02.2026, nuk e mbulon afatin kohor të implementimit të projektit sepse periodha e caktuar nga AK është 24 muaj.

Në lidhje me pretendimet tona të lartcekura, paneli shqyrtues në vendimin e saj edhe në këtë rast i kishte falur besimin konstatimeve të ekspertës shqyrtuese edhe përkundër faktit që konstatimet e ekspertës kanë qenë jo profesionale dhe jo të mbështetura në fakte konkrete. Ekspertja shqyrtuese në ekspertizën e saj për të gjitha pretendimet tona ankimore në lidhje me inxhinierët e prezantuar nga OE i rekomanduar për kontratë, kishte dhënë arsyetimin e njëjtë: Nuk ka qenë kërkesë e Autoritetit Kontraktues që CV dhe referenca të jene identike andaj ekspertja sqaron se dokumente e dorëzuar janë komfort kërkesave të Autoriteti Kontraktues. Nuk ka qenë pretendim i yni se a ka përputhje apo mospërputhje të të dhënave në CV dhe në referencë, mirëpo kontestuese nga ana jonë ka qenë dhe është se me referenca nuk dëshmohet përvoja e punës sipas kërkesës së dosjes së tenderit, prandaj është i papërgjegjshëm konsorciumi i rekomanduar për kontratë. Përvoja e punës duhet të dëshmohet me referenca pasi që referencën e lëshon punëdhënësi, e jo me CV sepse CV plotësohet nga vetë personi, prandaj për këtë arsye duhet të vlerësohen referencat e jo CV. Ekspertja shqyrtuese i ka dhënë fuqi më të madhe CV se sa referencës, prandaj këtu është gabimi i ekspertës shqyrtuese.

Siç e cekëm edhe më lartë paneli shqyrtues është dashur ti analizoj në detaje pretendimet tona ankimore, pasi që një gjë të tillë nuk e ka bërë ekspertja shqyrtuese, duke dhënë konstatime jo profesionale. Pra pretendimet tona kanë qenë që ka mospërputhje të dëshmime në lidhje me përvojën e punës së inxhinierëve, sepse sipas dëshmime të prezantuara inxhinierët nuk e dëshmojnë përvojën sipas kërkesave të dosjes së tenderit për vitet pas diplomimit. Ekspertja ka konstatuar se përvoja llogaritet nga koha e diplomimit, mirëpo ne sqarojmë se përvoja duhet të llogaritet nga momenti që ka filluar të punojë personi e jo nga diplomimi.

Po ashtu kontratat nuk kanë qenë të prezantuara vetëm për këtë projekt, por kanë qenë me afat më të gjatë e që konsiderohen kontrata të rregullta, prandaj është dashur të ofrohen dëshmitë nga ATK-ja e që realisht nuk janë prezantuar, prandaj konstatimet e ekspertës shqyrtues nuk kanë qenë të drejta dhe të sakta, andaj nuk është dashur të merren parasysh nga paneli i OSHP-së. Ne kemi pasur qasje në dokumentet e tenderit edhe pas rivlerësimit dhe nuk kemi vërejtur që AK-ja ka kërkuar sqarime shtesë në lidhje me dëshmitë nga ATK për inxhinierët e lartcekur. Në lidhje me pretendimin sa i përket dëshmime nga ATK, ekspertja shqyrtuese në ekspertizën e saj e kishte vërtetuar faktin se nuk janë ofruar dëshmitë nga ATK mirëpo ishte munduar të arsyetojë me faktin se pas formularit për korrigjim nuk është ndryshuar dosja e tenderit.

Konstatimi i ekspertës ka qenë plotësisht kundërligjor dhe joprofesional sepse në momentin që ngritet në sistem formulari për korrigjim atëherë ky formular është detyrues dhe realisht është pjesë e dosjes së tenderit dhe dëshmitë e kërkuara në këtë formular duhet të plotësohen për të qenë i përgjegjshëm një OE.

Sqarojmë se neni 24.7 i rregullores nr.001/2022 Për prokurim Publik e përcakton qartë si në vijim: *24.7 Nëse para afatit të fundit për dorëzim të tenderëve, bëhet e nevojshme nga AK që të ndryshohet ose përmirësohet Dosja e Tenderit, Lista e çmimeve, të dhënat në njoftim për kontratë, të bëhet zgjatja e afatit të fundit për dorëzim të tenderëve, atëherë ndryshimet ose përmirësimet nga AK bëhen vetëm duke përgatitur dhe publikuar*

Njoftimin për informata shitesë ose përmirësim gabime duke përdorur formularin standard B54.

Në rastin konkret është përdor formulari B54 ku edhe vetë ekspertja e kishte konstatuar një gjë të tillë, mirëpo më pastaj e kishte keqinterpretuar këtë dispozitë dhe rregullat ligjore duke ngatërruar formularin B54 me dosjen e tenderit, pra e njëjta i është referuar një dispozite e cila nuk ka të bëjë me pretendimet tona ankimore.

Pra në momentin që ngritet në sistem formulari B54 me ndryshimet e bëra rezulton se është ndryshuar dosja dhe me këto ndryshime janë njoftuar të gjithë të interesuarit në lidhje me këtë tender, prandaj në këtë rast trajtimi është i barabartë për të gjithë ofertuesit sepse është ngritur në sistem formulari B54 me ndryshimet e bëra.

Duke u bazuar në faktet e lartcekura OE i rekomanduar për kontratë është dashur të eliminohet nga ky aktivitet i prokurimit, sepse nuk i ka prezantuar dëshmitë nga ATK, mirëpo autoriteti kontraktues nuk i ka marr parasysh këto fakte, pasi që ka rekomanduar për kontratë një OE në kundërshtim me dispozitat ligjore të LPP-së dhe kërkesave të dosjes së tenderit.

OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm për faktin se nuk e plotëson edhe kërkesën tjetër të dosjes së tenderit “*Kërkesa 3: Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme, në tri vitet e fundit nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë, në vlerë min. 282,500.00 €*”, ku si dëshmi dokumentare është kërkuar “*Dëshmia 3: Lista e projekteve të kryera, duke plotësuar ANEKSIN 7 të Dosjes së Tenderit, në lëmin e punëve të ngjashme, të realizuar në tri vitet e fundit, nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë, duhet të dorëzohet në origjinal, i nënshkruar dhe i vulosur nga Operatori*

Ekonomik, DHE dëshmitë e përfundimit, Referenca/t ose Certifikata për Kryerjen e Punëve, Në rast se Operatori Ekonomik prezanton kontrata dhe referenca që janë të kontraktuara me subjekte private kombëtare ose ndërkombëtare, atëherë ato duhet të prezantohen Situacionet e nënshkruara së bashku me transaksionin bankar, që përputhet me të Njëjtën kontratë – Referencë”. - OE i rekomanduar për kontratë nuk e plotëson kërkesën e lartcekur për faktin se në ofertë i ka prezantuar 3 lista të ndryshme të kontratave të realizuara por që nuk janë të ngjashme sipas kërkesës së dosjes së tenderit. Kur analizohen kontratat dhe dëshmitë tjera të prezantuara për kërkesën e lartcekur, shihet qartë se i njëjti OE nuk e plotëson kërkesën sepse ka prezantuar në ofertë dëshmi të cilat nuk janë të natyrës së ngjashme me këtë aktivitet të prokurimit. OE i rekomanduar për kontratë në ofertë posedon kontrata dhe referenca të renovimeve të objekteve, andaj si të tilla të njëjtat nuk mund dhe nuk duhet ti merren parasysht.

Në lidhje me këtë pretendim tonin ankimor autoriteti kontraktues i ka kërkuar sqarime shtesë OE të rekomanduar për kontratë, ndërsa i njëjti ka prezantuar disa pranime teknike për disa prej kontratave të përfunduara. Në lidhje me këtë çështje, ju sqarojmë se dëshmitë e të njëjtit nuk mund dhe nuk është dashur të merren parasysht për faktin se dëshmitë e prezantuara nuk janë të natyrës së ngjashme, andaj edhe në këtë rast OE i rekomanduar për kontratë është dashur të eliminohet nga ky aktivitet i prokurimit. Kërkesa për sqarime nga AK-së është bërë në lidhje me kontratat si më poshtë: Pavarësisht këtyre sqarimeve, i njëjti konsorcium nuk e plotëson kërkesën e dosjes së tenderit për vlerën prej 282,500.00 €” kontrata të ngjashme të realizuar në tri vitet e fundit. OE i rekomanduar për kontratë nuk e plotëson edhe kërkesën tjetër të dosjes së tenderit ku është kërkuar “Kërkesa 4: Operatori Ekonomik duhet të jetë i pajisur me këto Certifikata ISO-ISO 9001-2015 (Certifikata për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë);- ISO 45001-2018 (Certifikata për Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë);- ISO 14001-2015 (Certifikata për Sistemin e Menaxhimit të Mjedisit)”, ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar “Dëshmia 4: Certifikatat Valide dhe Kopje e noterizuar”.I njëjti OE nuk e plotëson kërkesën e lartcekur për faktin se ISO STANDARDET me të cilat i njëjti është i certifikuar nuk i përkasin punëve të ngjashme, por është i certifikuar për “Punët e ndërtimeve banesore dhe jo banesore, renovime të objekteve dhe mirëmbajtja e të gjitha aktivitetëve rreth ndërtimit”.

OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm edhe për faktin se nuk i plotëson edhe kërkesat në lidhje me pajisjet, ku kërkesë e dosjes së tenderit ka qenë “Kërkesa 5: Operatori Ekonomik duhet të posedojë mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit, pajisjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës në Aneksin 8 të Dosjes së Tenderit”, ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar “Dëshmia 5: Pajisjet të cilat regjistrohen duhet të dëshmohen me librezën e regjistrimit (pajisjet duhet të jene me afat të regjistrimit), ndërsa pajisje tjera Operatori Ekonomik duhet ti dëshmoj me një dokument për pronësinë e pajisjeve (faturë, DUD etj.) Vëmendje! Në rast se OE nuk posedon pajisjet mbi pronësinë duhet të ofroj marrëveshjen për marrjen me qira të pajisjeve. Marrëveshja duhet të jete në emër të këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga të dyja palët.

Marrëveshja duhet të jete Origjinale apo Kopje e noterizuar në mes të qiradhënësit dhe qiramarrësit”. OE i rekomanduar për kontratë ka prezantuar një marrëveshje për shfrytëzim të makinerisë përkatësisht marrëveshja është lidhur ndërmjet AGE Group SHPK dhe EL BAU, mirëpo në marrëveshje nuk është cekur se e njëjta është e lidhur për kohëzgjatjen e kësaj kontrate, pasi që në kërkesën e dosjes së tenderi specifikohet saktë që duhet të jetë marrëveshja

me validitet të kohëzgjatjes së kësaj kontrate. Ky pretendim i yni ankimor nuk është trajtuar as nga ekspertja shqyrtuese dhe as nga paneli shqyrtues i OSHP-së, andaj ne edhe një herë po e sqarojmë se i njëjti OE është i papërgjegjshëm, sepse marrëveshja e lartcekur nuk është cekur se është lidhur për kohëzgjatjen e kësaj kontrate, ashtu siç është specifikuar në kërkesën e dosjes së tenderit. KAMIONI me targa te regjistrimit 06-683-FK, nuk i plotëson kërkesat e dosjes së tenderit për arsye sepse i njëjti nuk është kiper, por është vetëm koke tërheqëse. Ne aneksin 8 të dosjes së tenderit i cili është aneks obligativ të plotësohet, janë paraqitur shënimet e mëposhtme, mirëpo për të cilat nuk është prezantuar dokumentacion mbështetës, pasi që të njëjtat janë mjete të cilat regjistrohen dhe për të njëjtat është dashur të prezantohen librezat, mirëpo që dokumente të tilla nuk figurojnë.

Tek dëshmitë e prezantuara është vetëm një kamionetë kipper e cila nuk ka regjistrim valid te qarkullimit dhe e njëjta nuk figuron fare tek lista e pajisjeve nuk përkatësisht tek Aneksi 8 i dosjes së tenderit. Duke u bazuar në konstatimin e lartcekur AK-ja ka kërkuar sqarime shtesë, mirëpo kamioneta nuk e zëvendëson kamionin dhe nuk është dashur të kërkohen sqarime shtesë fare për validitet të regjistrimit i cili ka skaduar para datës së hapjes së ofertave.

Në lidhje me këtë pretendim tonin ekspertja shqyrtuese e kishte vërtetuar faktin se kamioni me targa 06-683-FK është vetëm koke tërheqëse e jo kamion, mirëpo kishte konstatuar se OE-ik ka dorëzuar edhe një kamionet me targa 06-517-FR e cila paska qene valide deri me datën e njoftimi te kontratës 24.05.2024 andaj duke hamendësuar për validitetin AK-se mund te kërkoje informatasqaruese. AK-së nuk ka vepruar konform kërkesave të dosjes së tenderit, pasi që duke i kërkuar sqarime shtesë këtij OE, e ka shfaqur haptas favorizimin që po i bën OE të rekomanduar për kontratë edhe përkundër faktit që i njëjti është i papërgjegjshëm. Më poshtë po ju prezantojmë me fotografi gjendjen faktike ku vërtetohen pretendimet tona ankimore: Për kërkesën e lartcekur nuk është ofruar dokumentacion mbështetës për makinerinë e ofruar në ofertë, sepse në dosje të tenderit janë kërkuar 2 kamioneta kipper, ndërsa OE e ka ofruar vetëm një. Pra mungon edhe 1 kamionetë

OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm edhe për faktin se sigurimi i tenderit i prezantuar në ofertë, posedon numrin e brendshëm të një aktiviteti tjetër dhe jo të këtij aktiviteti.

Vendimi për refuzim është publikuar me dt.11.09.2024 ku është refuzuar kërkesa për rishqyrtim, mirëpo nuk janë argumentuar e kundërta e pretendimeve ankimore. Për tre pretendimet e para ankimore në lidhje me stafin, autoriteti kontraktues ka dhënë përgjigje të njëjta duke përmendur kontratat për punëtorë, që janë të noterizuar tek noteri dhe vendimin e OSHP-së me gjithë ekspertizën.

Të njëjtat argumente i ka përdor edhe për pretendimin numër katër, e ku në përgjigje për këtë pretendim është munduar të arsyetohet me raport të ekspertizës në lidhje me çështjen e deklarimit të punëtorëve në ATK së paku në tremujorin e fundit, mirëpo nuk ka mundur të

argumentojë të kundërtën e pretendimit ankimor, se është dashur të ofrohen dëshmi për këta punëtor nga ATK-ja.

Në përgjigje i është referuar ekspertizës edhe pse ekspertiza në këtë pikë ka qenë e njëanshme, kurse nga paneli siç duket nuk janë analizuar në detaje pretendime tona ankimore por i kanë besuar ekspertizës, ku ekspertja shqyrtuese ka qenë e njëanshme dhe joprofesionale, duke e vënë në lajthitje edhe panelin shqyrtues.

Në lidhje me pretendimin ankimor se konsorciumi i rekomanduar për kontratë nuk i ka plotësuar vlerën e kërkuar për punë të ngjashme tri vitet e fundit, AK-së është arsyetuar se ka kërkuar sqarim dhe se kinse plotësohet kjo kërkesë. AK-së edhe në vlerësimin e kaluar ka pretenduar se plotësohet kjo kërkesë e edhe tani me sqarime pretendon një gjë të tillë, mirëpo edhe pas sqarimeve nuk plotësohet kjo kërkesë. Sqarime janë kërkuar edhe në lidhje me pajisjet mirëpo përsëri nuk janë plotësuar kërkesat e dosjes së tenderit dhe ky fakt është argumentuar në këtë ankesë, ku më lartë i kemi sqaruar në detaje këto çështje.

Duke u bazuar në të gjitha faktet e lartcekura kuptohet qartë se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm dhe si i tillë është dashur të cilësohet edhe nga ana e autoritetit kontraktues, mirëpo që e njëjta nuk e ka bërë një gjë të tillë duke e favorizuar të njëjtin edhe pse është i papërgjegjshëm.

Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë rezulton se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët sipas neni 60 paragrafi 1.1 i LPP-së. Gjithashtu AK-ja nuk e ka respektuar edhe nenin 7 të LPP-së, sepse na ka diskriminuar neve duke mos na shpallur fitues edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë dhe njëkohësisht jemi OE me çmim më të lirë. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që “Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente”. AK-ja është dashur të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke u referuar pretendimeve si më sipër “BAZALTI-S” SH.P.K konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 7, 59, 60 dhe 69 të LPP-së si dhe Neni 40 i Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik.

Përgjigje e AK ne kërkesën për rishqyrtim: Përgjigja e AK ndaj Pretendimit Ankimor me Nr. 1 Ju sqarojmë se lidhur me pretendimin tuaj ankimor, për Operatorin Ekonomik të rekomanduar për kontratë është i pabazuar. Sipas nenit 59 paragrafi 4 i LPP-ës, Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Operatori Ekonomik propozuar për Kontratë, ka ofruar bashkë me ofertën e tij edhe VENDIMIN për caktimin e Menaxherit të Projektit, z. Bushra Hashani. ku nga Kërkesa Nr. 2 të Kapaciteti teknik dhe profesional është kërkuar: 2.1. Menaxheri i Projektit - Inxhinier i Diplomuar Ndërtimtarisë ose master - Drejtimi Konstruktiv, me përvojë pune min. 6 vite pas diplomimit; Në Diplomën e prezantuar të Inxhinierit, z. Bushra Hashani, ceket se Inxhinieri në fjalë Studimet i mbarojë me datë: 07.05.1987, po ashtu Inxhinieri në CV e prezantuar ka përvojë pune min. 6 vite pas diplomimit; Kontrate e prezantuar është Kontratë Pune per Kohe te Caktuar, ku sipas Nenit 1 të kësaj Kontrate, ceket që Kontrata është nga data: 03.05.2024 deri ne: 03.05.2027; Neni 1 kontraktuesit janë marrë vesh që Bushra Hasani te kryej punë pranë kompanisë AGE group Sh.p.k me seli ne Rahovec nga viti 03.05.2024 deri ne 03.05.2027 punëtori mund te angazhohet në punë dhe detyra te punës qe i përgjigjen kualifikimit te tij si dhe punë tjera në kuadër të kompanisë sipas nevojës dhe konstantit të përgjegjësive të punës. Kontrata është e Noterizuar në Prani të palëve tek Noteri, Këtë e keni Verifikuar edhe ju si Operator Ekonomik Ankues nga qasja që kemi pasur në dokumentet e OE të rekomanduar për kontratë Në Vendimin e OSHP: 2024/0618, në gjetjen e Panelit Shqyrtues, thotë: Paneli vëren se raporti i ekspertizës është hartuar në një menjë profesional dhe përmban të gjitha pohimet dhe analizat lidhur me ankesën, duke i shpjeguar në mënyrë të detajuar shkëljet e identifikuar në përputhje me dispozitat e nenit 113 dhe 114 të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP). RAPORTI EKSPERTIT SHQYRTUES, lidhur me pretendimin Nr. 1 thotë: Andaj për këtë arsye pretendimin konsiderohet i pa bazuar.

Përgjigja e AK ndaj Pretendimit Ankimor me Nr. 2. Ju sqarojmë se lidhur me pretendimin tuaj ankimor, për Operatorin Ekonomik të rekomanduar për kontratë është i pabazuar. Sipas nenit 59 paragrafi 4 i LPP-ës, Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Operatori Ekonomik propozuar për Kontratë, ka ofruar bashkë me ofertën e tij edhe VENDIMIN për caktimin e Udhëheqësit të Punishtes, z. Sami Hoxha, ku nga Kërkesa Nr. 2 të Kapaciteti teknik dhe profesional është kërkuar: 2.2. Udhëheqësi i Punishtes - Inxhinier i Diplomuar i Arkitekturës ose master, me përvojë pune min. 5 vite pas diplomimit; Në Diplomën e prezantuar të Inxhinierit, z. Sami Hoxha, ceket se Inxhinieri në fjalë Studimet i mbarojë me datë: 27.02.2009, po ashtu Inxhinieri në CV e prezantuar ka përvojë pune min. 5 vite pas diplomimit; Kontrate e prezantuar është Kontratë Pune për Kohe te Caktuar, ku sipas Nenit 1 të kësaj Kontrate, ceket që Kontrata është nga data: 22.02.2024 deri ne: 22.02.2026; Neni 1 Kontraktuesit janë marrë vesh që Sami hoxha te kryej punë pranë kompanisë AGE group Sh.p.k me seli në Rahovec nga data 22.02.2024 deri me 22.02.2026. Punëtori mund të angazhohet në punë dhe detyra të punës që i përgjigjen kualifikimit të tij si: dhe punët tjera në kuadër të kompanisë sipas nevojës dhe konstatimit të përgjegjësive të punës. Kontrata është e

Noterizuar në Prani të palëve tek Noteri; Në Njoftimin e kontratës dhe në Dosjen e tenderit nuk është kërkuar që kontrata me Inxhinierin të jetë me periudhë, sipas pretendimit tuaj ankimor. Paragrafit 3 të nenit 56 të LPP-ës, thotë: Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkesë ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Në Vendimin e OSHP: 2024/0618, në gjetjen e Panelit Shqyrtues, thotë: Paneli vëren se raporti i ekspertizës është hartuar në mënyrë profesionale dhe përmban të gjitha pohimet dhe analizat lidhur me ankesën, duke i shpjeguar në mënyrë të detajuar shkeljet e identifikuar në përputhje me dispozitat e nenit 113 dhe 114 të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP). RAPORTI EKSPERTIT SHQYRTUES, lidhur me pretendimin Nr. 2 thotë: Andaj për këtë arsye pretendimin konsiderohet i pa bazuar.

Përgjigjja e AK ndaj Pretendimit ankimor me Nr. 3 Ju sqarojmë se lidhur me pretendimin tuaj ankimor, për Operatorin Ekomomik të rekomanduar për kontratë është i pabazuar. Sipas nenit 59 paragrafi 4 i LPP-ës, Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Kontrate e prezantuar është Kontratë Pune për Kohe te Caktuar, ku sipas Nenit 1 të kësaj Kontrate, ceket që Kontrata është nga data: 28.02.2024 deri ne: 28.02.2026: Neni 1 Kontraktuesit janë marre vesh që Valon Jahaj të kryej punë pran kompanisë AGE group Sh.p.k me seli ne Rahovec nga data 28.02.2024 deri me 28.02.2026 Punëtori mund të angazhohet ne punë dhe detyre të punës që i përgjigjen kualifikimit te tij si dhe Punë tjera ne kuadër të kompanisë sipas nevojës dhe kualifikimit te përgjegjësishë se punës. Kontrata është e Noterizuar në Prani të palëve tek Noteri; Në Njoftimin e kontratës dhe në Dosjen e tenderit nuk është kërkuar që kontrata me Inxhinierin të jetë me periudhë, sipas pretendimit tuaj ankimor. Paragrafit 3 të nenit 56 të LPP-ës, thotë: Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkesë ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Në Vendimin e OSHP: 2024/0618, në gjetjen e Panelit Shqyrtues, thotë: Paneli vëren se raporti i ekspertizës është hartuar në mënyrë profesionale dhe përmban të gjitha pohimet dhe analizat lidhur me ankesën, duke i shpjeguar në mënyrë të detajuar shkeljet e identifikuar në përputhje me dispozitat e nenit 113 dhe 114 të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP). RAPORTI EKSPERTIT SHQYRTUES, lidhur me pretendimin Nr. 3 thotë: Andaj për këtë arsye pretendimin konsiderohet i pa bazuar. ***Përgjigjja e AK ndaj Pretendimit Ankimor me Nr. 4.*** Ju sqarojmë se lidhur me pretendimin tuaj ankimor, për Operatorin Ekonomik të rekomanduar për kontratë është i pabazuar. Sipas nenit 59 paragrafi 4 i LPP-ës, Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Kontrate e prezantuar është Kontratë Pune per Kohe te Caktuar, ku sipas Nenit 1 të kësaj Kontrate, ceket që Kontrata është nga data: 26.02.2024 deri ne: 26.02.2026: Neni 1 Kontraktuesit janë marr vesh që Gazmend Bega) të kryej punë pranë kompanisë AGE group Sh.p.k me seli në Rahovec nga data 26.02.2024 deri ne 26.02.2026 Punëtori mund të angazhohet në punë dhe detyra të punës që i përgjigjen kualifikimit të tij dhe punët tjera në kuadër të kompanisë sipas nevojës dhe konstatimit të përgjegjësit të punës. Kontrata është e Noterizuar në Prani të palëve tek Noteri; Në Njoftimin e kontratës dhe në Dosjen e tenderit nuk është kërkuar që kontrata me Inxhinierin të jetë me periudhë, sipas pretendimit tuaj ankimor. Paragrafit 3 të nenit 56 të LPP-ës, thotë: Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkesë ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e

tenderit. Në Vendimin e OSHP: 2024/0618, në gjetjen e Panelit Shqyrtues, thotë: Paneli vëren se raporti i ekspertizës është hartuar në mënyrë profesionale dhe perban të gjitha pohimet dhe analizat lidhur me ankesën, duke i shpjeguar në mënyrë të detajuar shkeljet e identifikuara në përputhje me dispozitat e nenit 113 dhe 114 të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP). RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES, lidhur me pretendimin Nr. 4 thotë: Andaj për këtë Arsye pretendimin konsiderohet i pa bazuar. Përgjigjja e AK ndaj Pretendimit Ankimor me Nr. 5 Ju sqarojmë se lidhur me pretendimin tuaj ankimor, për Operatorin Ekonomik të rekomanduar për kontratë është i pabazuar. Sipas nenit 59 paragrafi 4 i LPP-ës, Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Operatorin Ekonomik të rekomanduar për kontratë ka plotësuar Kërkesën Nr. 3 Kapaciteti teknik dhe profesional, dhe ka dëshmuar Referencat të natyrës së ngjashme, në tri vitet e fundit nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë, në vlerën e Kërkuar sipas Njoftimit e kontratës dhe Dosjes së tenderit. Në Vendimin e OSHP: 2024/0618, në gjetjen e Panelit Shqyrtues, thotë: Paneli vëren se raporti i ekspertizës është hartuar në mënyrë profesionale dhe përmban të gjitha pohimet dhe analizat lidhur me ankesën, duke i shpjeguar në mënyrë të detajuar shkeljet e identifikuara në përputhje me dispozitat e nenit 113 dhe 114 të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP). RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES, në Nr. e lëndës: 2024/0618, ka dhënë përgjigje për këtë çështje, duke cekur: disa që ekspertja ka konstatuar si të pranueshme disa referenca të dorëzuara është afro 178 mijë që nuk përbush kërkesat e AK-se pasi që vlera e kërkuar është vlerë më shumë se 282,500.00€. Mirëpo në bazë të tre (3) listave të ofruara (do të bashkëngjis në fund të raportit vetëm listat pasi që kontrata dhe referencat të cilat i kanë dorëzuar për arsye të ngarkesë nuk mundmë të i bashkëngjis gjenden në platformën e e-prokurimit për feri fikim) nga tenderuesi janë disa kontrata që mund të konsiderohen si pune të ngjashme dhe bazë të nenit 72 të UDHËZUES Nr. 001/2023 PËR PROKURIMIN Mungon referenca/certifikata e pranimit nga lista e kontratave të prezantuara - Mund të kërkohej informata sqaruese, ka mundur të kërkojë informata sqaruese në bazë të listës së dorëzuar për disa projekte. Në bazë të formularit B47 Letër Standarde e kërkesës për sqarimin e tenderit kemi kërkuar sqarime: Në bazë të Vendimit të OSHP-së Nr. 2024/0618 dhe Në bazë të Ligjit të Prokurimit Publik, në përputhje me nenin 72 kërkoj sqarime shtesë ku thotë: Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji; Në ofertën e juaj të prezantuar, nuk janë dorëzuar-mungojnë Referenca/t ose Certifikata për Kryerjen e Punëve (Raportet e Pranimit Teknik), për Kontratë që mund të konsiderohen si punë të ngjashme; Kërkojmë të dorëzoni Referenca/t ose Certifikata për Kryerjen e Punëve (Raportet e Pranimit Teknik) për projekte: Investime në Zonën Ekonomike - Parku Industrial në Opterushë; Riparimi i Tregut të Gjeibër Ditor; Ndërtimi Shkollës Filllore "Milaim Krasniqi" në Kaznik; Investime në Infrastrukturën Kulturore dhe në Këndë të Lojërave për Fëmijë; Ankesë Kontratë: Investime në Infrastrukturën Kulturore dhe në Këndë të Lojërave për Fëmijë; Bazuar në tabelarin e UDHËZUES Nr. 001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK, në faqen 40 kemi shëmbullin se si duhet vepruar: Në si Autoritet Kontraktues: Komuna e Rahovecit, kërkojmë nga ana juaj të na dorëzoni informacionet që mungojnë, në bazë të sqarimeve të lartcekura, duke u bazuar në nenin 72 Operatori Ekonomik ka dorëzuar Raportet e Pranimit Teknik për projekte: Investime në Zonën Ekonomike - Parku Industrial në Opterushë; 68,460.00 Euro; Ndërtimi Shkollës Filllore "Milaim Krasniqi" në Kaznik; 79,857.07 Euro; Investime në Infrastrukturën Kulturore dhe në Këndë të Lojërave për Fëmijë; 83,373.31 Euro; Në vlerë totale prej: 231,690.38 Euro Në si AK e kemi respektuar Vendimin e OSHP: 2024/0618 Përgjigjja e AK ndaj Pretendimit Ankimor me Nr. 6 Ju sqarojmë se lidhur me pretendimin tuaj ankimor, për Operatorin Ekonomik të rekomanduar për kontratë është i pabazuar, Sipas nenit 59 paragrafi 4 i

LPP-ës, Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Operatorin Ekonomik të rekomanduar për kontratë ka plotësuar Kërkesën Nr. 4 Kapaciteti teknik dhe profesional, sipas Njoftimin e kontratës dhe Dosjes së tenderit. Në bazë të pretendimit tuja ankimor ku keni cekur se certifikatat nuk i përkasin punëve të ngjashme, në Dosjen e Tenderit nuk është cekur Fushë veprimtaria e Certifikatës, por në Certifikatat e Operatorit Ekonomik të rekomanduar për kontratë, ndër të tjera është fushë veprimtaria për Punëve e ndërtimeve jo banesore, ku ka të bëjë me këtë aktivitet të prokurimit. Në Vendimin e OSHP: 2024/0618, në gjetjen e Panelit Shqyrtues, thotë: Paneli vëren se raporti i ekspertizës është hartuar në mënyrë profesionale dhe përmban të gjitha pohimet dhe analizat lidhur me ankesën, duke i shpjeguar në mënyrë të detajuar shkeljet e identifikuara në përputhje me dispozitat e nenit 113 dhe 114 të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP). RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES, lidhur me pretendimin Nr. 6 thotë: Ekspertja konstaton se ky pretendim është i pa Bazuar.

Përgjigjja e AK ndaj Pretendimit Ankimor me Nr. 7 Ju sqarojmë se lidhur me pretendimin tuaj ankimor, për Operatorin Ekonomik të rekomanduar për kontratë është i pabazuar. Sipas nenit 59 paragrafi 4 i LPP-ës, Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Operatorin Ekonomik të rekomanduar për kontratë ka plotësuar Kërkesën Nr. 5 Kapaciteti teknik dhe profesional, dhe ka dëshmuar se posedojë mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit sipas tabelës në Aneksin 8 të Dosjes së Tenderit, të përcaktuara në Njoftimin e kontratës dhe Dosjes së tenderit. Në Vendimin e OSHP: 2024/0618, në gjetjen e Panelit Shqyrtues, thotë: Paneli vëren se raporti i ekspertizës është hartuar në mënyrë profesionale dhe përmban të gjitha pohimet dhe analizat urdhër me ankesën, duke i shpjeguar në mënyrë të detajuar shkeljet e identifikuara në përputhje me dispozitat e nenit 113 dhe 114 të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP). RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES, në Nr. e lëndës: 2024/0618, ka dhënë përgjigje për këtë çështje, duke cekur: Ekspertja sqaron se për pretendimin për kamionin 06-683-FK është vetëm koke tërheqëse mirëpo OE-ik ka dorëzuar edhe një kamionët me targa 06-517-FR e cila paska qen valide deri me datën e njoftimi të kontratës 24.05.2024 andaj duke hamendësuar për valeditetin AK-se mund të kërkojë informata sqaruese, Në bazë formularit B47 Letër Standarde e kërkesës për sqarimin e tenderit kemi kërkuar sqarime: Ne ofertën e juaj të prezantuar, tek Lista e Pajisjeve të prezantuara, keni prezantuar edhe një Kamionë me targa 06-517-FR e cila ka qenë valide deri me datën e Njoftimi të Kontratës: 24.05.2024, andaj duke hamendësuar për validitetin, Ne si Autoritet Kontraktues: Komuna e Rahovecit, kërkojmë nga ana juaj të na dorëzoni informacionet që mungojnë, në bazë të sqarimeve të lartcekura, duke u bazuar në nenit 72 . Operatori Ekonomik ka dorëzuar Librezën e Regjistrimit të Kamionit me targa 06-517-FR Pretendimi juaj në këtë pikë është i pabazuar

Përgjigjja e AK ndaj Pretendimit Ankimor me Nr. 8. Ju sqarojmë se lidhur me pretendimin tuaj ankimor, për Operatorin Ekonomik të rekomanduar për kontratë është i pabazuar. Sipas nenit 59 paragrafi 4 i LPP-ës, Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Operatorin Ekonomik të rekomanduar për kontratë, ka dorëzuar Sigurimin e tenderit në përputhje me Neni 13.2 të Dosjes së Tenderit dhe Njoftimit për kontratë. Në bazë të pretendimit tuja ankimor ku keni cekur se posedon numrin e brendshëm për një aktivitet tjetër të prokurimit dhe jo të këtij aktiviteti, nuk që qëndron ngase Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë, tek Sigurimi i tenderit i dorëzuar, ka prezantuar Numrin e

këtij aktiviteti të prokurimit. Në Vendimin e OSHP: 2024/0618, në gjetjen e Panelit Shqyrtues, thotë: Paneli vëren se raporti i ekspertizës është hartuar në mënyrë profesionale dhe përmban të gjitha pohimet dhe analizat lidhur me ankesën, duke i shpjeguar në mënyrë të detajuar shkeljet e identifikuar në përputhje me dispozitat e nenit 113 dhe 114 të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP). RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES, lidhur me pretendimin Nr. 8 thotë: Andaj ekspertja konsideron se ky pretendim është i pa Bazuar. Përgjigjja e AK ndaj Pretendimit Ankimor me Nr. 9. Ju sqarojmë se lidhur me pretendimin tuaj ankimor, për Operatorin Ekonomik të rekomanduar për kontratë është i pabazuar. Sipas nenit 59 paragrafi 4 i LPP-së, Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pretendimi juaj në këtë pikë është i pabazuar. Pretendimi ankimor i parashtruar nga OE me Nr. 10 citoj: AK-ja është dashur të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së. pasi që dihet se qëllimi i këtij Ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të Shfrytëzimit. të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë. Përgjigjja e AK ndaj Pretendimit Ankimor me Nr. 10. Oferta juaj është: 165,888.00 Euro, ndërsa Oferta e Operatori Ekonomik të rekomanduar për kontratë është: 154,616,65 Euro, ku diferenca është: 11,271.35 Euros dhe ne si AK e kemi respektuar plotësisht Nenin 1 të LPP-së; Pretendimi juaj në këtë pikë është i pabazuar. Nga konstatimet e lartcekur u vendos si në dispozitave të këtij Vendimi.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave -

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit është autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës 2024/0884. Lidhur me ankesën nr. 2024/0884 eksperti shqyrtues në raportin e vet tek rubrika - rekomadimi i ekspertit ka plotësuar se për te njejtat pretendime është përgjigjur në raportin paraprak.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për te vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtruesit e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritore lidhur me rastin.

Paneli Shqyrtues thekson faktin se është përgjegjësi ekskluzive e Autoritetit Kontraktues për të bërë ekzaminimin, krahasimin dhe vlerësimin e ofertave por edhe dhënien e kontratave të prokurimit publik, mirëpo në këtë rast Paneli konsideron se AK edhe pas rivleresimit nuk ka administruar aktivitetin në zbatim të dispozitave ligjore të LPP e në veqanti në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së. Paneli Shqyrtues dhe ai që më pak ekspertët shqyrtues nuk mund të lëshohen në vlerësimin e ofertave por vetëm gjykojnë nëse veprimet e AK janë në përputhje ose jo me dispozitat në fuqi të LPP dhe legjislacionit sekondar për prokurimin publik.

Paneli Shqyrtues gjatë krahasimit të dokumentacionit, sikurse në vendimin paraprak (0618/2024) që i ka falur besimin përgjigjeve të dhëna në raport të ekspertizës lidhur me pretendimin ankimor nr.5 për të cilat OE ankues pretendon se OE i rekomanduar për kontratë nuk plotëson vlerën e kërkuar lidhur me referencat për punë të ngjashme, PSH ka konstatuar se AK gjatë rivleresimit duhet të ndermerr hapat e nevojshëm e që duke vërejtur që OE i rekomanduar për kontratë nuk plotëson këto kërkesa në dosje të tenderit, OE i rekomanduar për kontratë gjatë rivleresimit

duhej të cilesohet si i papërgjegjshëm për këte aktivitet të prokurimit. Një gjë tjetër e tillë AK nuk e ka trajtuar sipas dispozitave ligjore, andaj PSH konstaton se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm për këte aktivitet të prokurimit. Eksperti në raportin paraprak lidhur me këtë pretendim ankimor ka sqaruar : " - **Lidhur me pretendimin e V-të, të Operatorit Ekonomik ankues : ekspertja shqyrtuese fillimisht për këto pretendime potencon se kërkesat e Autoritetit Kontraktues Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale - Kërkesa 3: Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontratë të natyrës së ngjashme, në tri vitet e fundit nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë, në vlerë min. 282,500.00€.**

*Dëshmia e kërkuar dokumentare Dëshmia 3: Lista e projekteve të kryera, duke plotësuar ANEKSIN 7 të Dosjes së Tenderit, në lëmin e punëve të ngjashme, të realizuar në tri vitet e fundit, nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë, duhet të dorëzohet në origjinal, i nënshkruar dhe i vëlosur nga Operatori Ekonomik, DHE dëshmitë e përfundimit, Referenca/t ose Certifikata për Kryerjen e Punëve, Në rast se Operatori Ekonomik prezanton kontratë dhe referencë që janë të kontraktuara me subjekte private kombëtare ose ndërkombëtare, atëherë ato duhet të prezantohen Situacionet e nënshkruara së bashku me transaksionin bankar, që përputhet me të Njëjtën kontratë - Referencë; Ekspertja shqyrtuese në bazë të dëshmiave të dorëzuara nga OE-ik i propozuar për dhenje të kontratës sqaron se dëshmitë e ofruara janë shumica Mirëmbajtje, Renovime dhe Ndërtime të objekteve, andaj duke shqyrtuar kërkesën e AK-se ku thuhet se Lista e projekteve të kryera, duke plotësuar ANEKSIN 7 të Dosjes së Tenderit, në lëmin e punëve të ngjashme, të realizuar në tri vitet e fundit dhe duke analizuar përshkrimin e Paramasës (përshkrimin e çmimit) të cilin ka dhen AK-se në të cilin punime do të behën në rrugë si asfalt, matje gjeodezike , ekspertja sqaron se punë ngjashme në këtë rast konsiderohen punët e ndërtimit të ulet (ndërtimi i rrugëve , urave etj) sepse bazuar edhe në udhëzuesin administrativ MMPH-04/2017-UA të ndërtimit për kategorizimin e ndërtimeve. Vlera që ekspertja ka konstatuar si të pranueshme disa referencë të dorëzuara është afro 178 mijë gjë që nuk përbush kërkesat e AK-se pasi që vlera e kërkuar është vlerë min. 282,500.00€. Mirëpo në bazë të tre (3) listave të ofruara(do të bashkëngjis në fund të raportit vetëm listat pasi që kontratë dhe referencat të cilat i kanë dorëzuar për arsye të ngarkesë nuk mundmë të i bashkëngjis gjenden në platformën e e-prokurimit për feri fikim) nga tenderuesi janë disa kontratë që mund të konsiderohen si punë të ngjashme dhe bazë të nenit 72 të UDHËZUES Nr.001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK pika e parë thotë 10. Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve se Mungon referencë/certifikatë e pranimi nga lista e kontratave të prezantuara – Mund të kërkojnë informata sqaruese ka mundur të kërkojë informata sqaruese në bazë të listës e dorëzuar për disa projekte. **Andaj ekspertja konsideron se ky pretendim është i Bazuar.***

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkruesat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues sikurse edhe në raportin paraprak ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik “BAZALTI-S” SH.P.K” duhet të miratohet si pjesërisht e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të anuluar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues – “KUVENDI KOMUNAL – RAHOVECË” të datës 05.09.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me “NDËRTIMI I URAVE NË KOMUNËN E RAHOVECIT” me nr. të prokurimit 623-24-5118-5-2-1.

Paneli Shqyrtueska vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së

shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës.

Paneli Shqyrtues kërkon nga Autoriteti Kontraktues që të jetë i vëmendshëm gjatë procedurave të prokurimit publik duke vepruar në përputhje të plotë me LPP dhe legjislacion tjetër në fuqi për prokurimin publik si dhe të veprojnë në harmoni me të gjeturat e këtij vendimi. Në të kundërtën OSHP mund të iniciojë procedurat disiplinore ndaj zyrtarëve të prokurimit.

Për pikën I, II dhe III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën IV të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën V të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Kimete Gashi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI KOMUNAL - RAHOVECË**
- **OE - " BAZALTI-S " SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: